



المجلس المصري للشؤون الخارجية  
Egyptian Council for Foreign Affairs



AKADEMIA DIPLOMATIKE E REPUBLIKES SE  
KOSOVES  
Diplomatska Akademija Republike Kosova  
Diplomatic Academy of the Republic of Kosovo

## Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi ndërmjet

### Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës

dhe

### Këshillit Egjiptian për Punë të Jashtme A.R.E.<sup>1</sup>

Për të përmirësuar më tej mirëkuptimin e ndërsjellë dhe miqësinë ndërmjet popujve të Republikës Arabe të Egjiptit dhe të Republikës së Kosovës dhe me qëllim të promovimi të zhvillimit të marrëdhënieve miqësore institucionale, Këshilli Egjiptian për Punë të Jashtme (ECFA) dhe Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës janë dakorduar si në vijim:

#### Neni 1: Udhëzimet e përgjithshme

Të dyja palët dakordohen për zhvillimin e shkëmbimeve dhe zhvillimin e bashkëpunimit në bazë të respektit, barazisë dhe përfitimit reciprok.

#### Neni II: Përmbajtja e Bashkëpunimit

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi përfshin:

- Promovimin e shkëmbimit të vizitave në baza ad hoc;
- Bashkë-financimin e simpoziumeve bilaterale mbi çështjet me interes të përbashkët;
- Shkëmbimin e publikimeve;
- Forma tjera të bashkëpunimit të dakorduara nga të dyja palët nëpërmjet konsultimeve
- Organizimi i takimeve alternative;
- Promovimi i projekteve të përbashkëta në nivel bilateral dhe rajonal, etj .;

### Neni III: Shpenzimet

Mbi bazën e reciprocitetit, pala vizituese në takimet dhe vizitat bashkërisht të dakorduara do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit ndërkombëtar, ndërsa pala nikoqire do të mbulojë transportin lokal dhe akomodimin. Përndryshe, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta, përveç nëse nuk vendoset ndryshe.

### Neni IV: Tjera


Sa i përket çështjeve tjera që Memorandumi nuk i mbulon, do të vendoset me anë të konsultimeve të ndërsjella sipas rastit.

### Neni V

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të tij dhe do t'i nënshtrohet modifikimeve sipas marrëveshjeve të përbashkët, atëherë kur kjo është e nevojshme. Megjithatë, përfundimi i këtij Memorandumi nuk do të ndikojë në vlefshmërinë ose kohëzgjatjen e çfarëdo programi aktual.

Nënshkruar në Prizren, më 15 maj 2013

-----  
Kryesuesi  
Për Akademinë Diplomatike  
të Republikës së Kosovës

  
-----  
Kryesuesi  
Për ECFA

